



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7903 prot.

Himarë, më 21.10 . 2025

VENDIM

Nr. 50 . Datë 17/10/2025

PËR

**“NGRITJEN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR
TITUJT VENDORË TË NDERIT, SI DHE EMËRTIMIN E RRUGËVE,
SHESHEVE, TERRITOREVE,
INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE NË JURIDIKSIONIN E BASHKISË
HIMARË”**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (i përditësuar), ligjin nr. 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM-në nr. 861 datë 10.02.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Hollësishme për Funksonimin e Komisioneve Këshillimore për Dhënien e Medaljeve dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” si dhe “Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak Himarë, me propozim të Komisionit të Mandateve, pranë Këshillit Bashkiak Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 17.10.2025, miratoi me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

- 1- Ngritjen e “Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit, si dhe Emërtimin e Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe Objekteve në Juridiksionin e Bashkisë Himarë”, me këtë përberje:

- Timoleo Gërdhuqi
- Artionil Shirokaj
- Milto Nika
- Amalia Rondo
- Ruzhdi Barjamaj

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj

